



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORE

Nr. Akti 110 (71018-00160-61-2014)
Date 03.02.2014

Nr. Vendimi 110 (61(61-2014-446)
Date 10.02.2014

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS “

Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Vlorë e përbërë nga :

Skënder HALUCI -GJYQTAR

Asistuar prej sekretares se seancës gjyqësore Eglantina Murati , sot në Dt 10.02.2014 , mori në shqyrtim në seance gjyqësore publike çështjen penale me Nr. 110 (71018-00160-61-2014) Akti Dt. 03.02.2014 që i përket:

KERKUESE: Prokuroria e Rrethit Gjyqësorë Vlorë, e përfaqësuar nga prokurorë

OBJEKTI: Konfiskimin e mjetit lundruar tip gomone, sekuestruar me procesverbalin e datës 26.01.2014.

BAZA LIGJORE: Nenet 23/3 dhe 24/3 I Ligjit Nr. 8663, date 18.09.2000 “Per regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT”

Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen, administroi dhe shqyrtoi provat ne tërësi, dëgjoji prokurorinë ne konkluzionet përfundimtare qe kërkoi :

Prokuroria a Rrethit Gjyqësorë Vlorë kërkoi :

- Pranimin e kërkesës
- Konfiskimin e mjetit lundruar tip gomone, sekuestruar me procesverbalin e datës 26.01.2014.

VEREN

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësorë Vlorë është paraqitur kërkesa per Konfiskimin e mjetit lundruar tip gomone, sekuestruar me procesverbalin e datës 26.01.2014.

Lidhur me këtë mjet, Prokuroria e Rrethit Gjyqësorë Vlorë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 204 per vepren penale te parashikuar nga neni 23/1 I Ligjit Nr. 8663, date 18.09.2000 “Per regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT”.

Ne hetimin paraprak për këtë procedim penal ka rezultuar se me datë 25.01.2014, ora 10.00, Shërbimet e Policisë të Stacionit të Policisë Kufitare në Dhërmi-Vlorë në zonën e plazhit të Gjirit të Gjipese rreth 10 m larg bregut të detit kanë konstatuar një mjet lundrues tip gomone, me ngjyë gri në të bardhë, me mbishkrimin "STILMAR730" në të dy krahët anësore të turbolareve të gomones, i pa matrikulluar, me dy motora model MERCURY me fuqi motorike 225 HP dhe 25 HP me ngjyre të zeze, me gjatësi 7 m dhe gjerësi 2 m, e cila ishte e braktisur nga pronaret.

Gjate kontrollit të këtij mjeti lundrues dhe ambientit përreth nuk është konstatuar ndonjë send i kundraligjshëm. Ky mjet lundrues është shoqëruar për në bankinën e mjeteve lundruese në Porto-Romano, për shkak të kohës së keqe. Pasi janë kryer verifikimet për dokumentacionin e këtij mjeti ka rezultuar se ai nuk ishte i regjistruar në policinë kufitare dhe nuk ishte i matrikulluar, prandaj është sekuestruar me procesverbalin e datës 26.01.2014 të Opg. [REDAKTUAR]

Në këto kushte Prokuroria e Rrethit Gjyqësorë Vlorë, bazuar në nenin 23/3 dhe 24/3 i Ligjit Nr. 8663, datë 18.09.2000 i ka kërkuar gjykatës Konfiskimin e mjetit lundrues tip Gomone, të sekuestruar me procesverbalin "Mbi sekuestrimin e mjetit lundrues" të datës 26.01.2014.

I. Ligji i Zbatueshëm.

Neni 12 i Ligjit Nr. 8663, datë 18.09.2000, "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT" përcakton se:

"Çilido që zotëron ose mban me çfarëdo lloj titulli një mjet lundrues ose pjesë të tij duhet të bëjë deklaramë të shkruar brenda njëzet e katër orëve nga marrja në zotërim ose mbajtja në zyrën e policisë kufitare përgjegjëse për territorin duke shënuar gjeneralitetet dhe vendqëndrimin e tij, vendbanimin e përhershëm të mjetit dhe gjeneralitetet e pronarit apo bashkëpronarit".

Në nenin 23/1 të Ligjit Nr. 8663, datë 18.09.2000, "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT" përcaktohet se:
"Mosdeklarimi i zotërimit apo mbajtjes sipas nenit 12 të këtij ligji përben kundravajtje penale dhe shoqërohet me konfiskimin e mjetit lundrues nga oficeri i policisë gjyqësore".

Në nenin 24/1 të Ligjit Nr. 8663, datë 18.09.2000, "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT", përcaktohet se:
"Mungesa e matrikullimit ose e regjistrimit sipas nenit të këtij ligji përben kundravajtje penale dhe dënohet me gjobe dhe shoqërohet me konfiskim të mjetit lundrues".

Kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Vlorë, bazohet në; Nenet 23/3 dhe 24/3 të Ligjit Nr. 8663, datë 18.09.2000, "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT"

Aktet provuese mbi të cilat mbështet kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Vlorë, janë:

- Urdhër për regjistrimin e procedimit penal, datë 27.01.2014;
- Informacion për referimin e veprës penale tek prokurori, datë 26.01.2014;
- Procesverbal për konstatimin e shkeljes, datë 25.01.2014, ora 10.00;

- *Procesverbal per kqyrjen dhe marrjen e provës material, (mjet lundrues) date 26.01.2014, ora 16.00;*
- *Vendim per sekuestrimin e mjetit lundrues, date 26.01.2014;*
- *Vendim per vlefësimin e sekuestrimit, date 27.01.2014;*
- *Procesverbal per dorëzimin dhe lënien ne ruajtje te mjetit lundrues ne piken e bllokimit, date 26.01.2014, ora 19.00;*
- *Raport shërbimi, date 25.01.2014, ora 10.00*

Si dhe te gjitha aktet e tjera te administruara ne fashikullin e gjykimit.

Ne analize te rrethanave te parashtrimit te kësaj kërkesë gjykata vlerëson se kërkesa e Prokurorisë se Rrethit Gjyqësorë Vlore, per: *Konfiskimin e mjetit lundrues tip Gomone, te sekuestruar me procesverbalin "Mbi sekuestrimin e mjetit lundrues" te datës 26.01.2014.* është e bazuar dhe si e tille duhet te pranohet nga gjykata.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 384 të K.Pr.Penale si dhe ne Nenet 23/3 dhe 24/3 I Ligjit Nr. 8663, date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT"

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konfiskimin e mjetit lundrues tip gomone, sekuestruar me procesverbalin "Mbi Sekuestrimin e Mjetit Lundrues" te datës 26.01.2014.
3. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësorë Vlore, per ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Shpenzimet proceduriale siç janë bere.
5. Kundër vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 10 ditësh duke filluar ky afat nga e nesërnmja e shpalljes.


U shpall ne Vlore sot ne date 10.02.2014!

SEKRETARE

Eglantina MURATI




GJYKOTAR
Skënder HALUCI



Therese
Shenë Shkurti Shkurti


VENDIMI MORI FORME TE PRERE
PASI NUK U ANKIMUA
me date 20.02.2014
K/SEKRETARE
REZARTA TAUSHANI



SHPENZIMET GJYQËSORE

Shpenzime kancelarie	200 Lekë
Shpenzime totale	200 Leke

Sekretare
Eglantina Murati

